



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
ismail rushiti	18.12.2023	28.12.2023	2023/1001
Eksperti Teknik	Data e autorizimit të ekspertit teknik		
Kreshnik Spahiu	19.12.2023		

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 11.12.2023, OE “Quantix L.L.C.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/1001, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Quantix L.L.C.”- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Krijimi i sistemit elektronik te proceseve per nevojat e Komisionit te Pavarur per Media E-KPM-ja” me nr. të prokurimit: "UA/2016-23-9009-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia Qendrore e Prokuimit .Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 250,000.00 €. Më Nr. 2023/1001 i dt:11.12.2023.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

NENI 1 i LPP-së

NENI 7 i LPP-së

NENI 10 i LPP-së

NENI 11 i LPP-së

NENI 59 i LPP-së

NENI 60 i LPP-së

NENI 69 i LPP-së

Të nderuar ne me dt. 27.11.2023 përmes e-prokurimit jemi njoftuar me njoftimin vendimin e AK-së, ku është rekomanduar për kontratë grupin e OE Data Prognnet Shp çmim prej 118,000.00€ ndërsa ne jemi shpallur si tenderues i pasuksesshëm.

Ne kemi kërkuar qasje në dokumentacion të OE të rekomanduar për kontratë mirëpo ne është lejuar qasje plotë, prandaj autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 10 të LPP-së e po ashtu nuk ka përgatitur versionin e pastruar sipas nenit 11 të LPP-së, prandaj shkelje duhet korrigjuar.

Arsyetimi i AK-së se OE kanë plotësuar aneksin 3 Kërkesa për sekret afarist është arsy i paqëndrueshëm sepse autoriteti kontraktues mundet që sipas paragrafit 4 të nenit 11 të LPP-së të përgatit versionin e pastruar, por që një veprim i tillë nuk është ndërmarr nga autoriteti kontraktues.

Grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka deklaruar si sekret afarist të gjithë dosjet e tenderit -dokumentet e dorëzuara. Ne nuk kemi pasur mundësi të qasjes në dosje, andaj mungesë të shikimit të dokumentacionit ne duhet të ngritim pretendime me dyshime, dyshojmë se i njëjti

Operatori Ekonomik DataProgNet SH.P.K është i papërgjegjshëm me arsyetimet vijim:

Nuk na është lejuar të shohim listën e stafit, prandaj dyshojmë se ky OE nuk përmban kërkesën në lidhje me përvojën e stafit kërkuar sipas dosjes së tenderit.

Nuk na është lejuar të shohim dosjen e stafit të angazhuar, referenca, diploma, certifikata, apo kontrata, prandaj dyshojmë se stafi i angazhuar dhe dëshmitar ofruara nga ky OE nuk janë sipas dosjes së tenderit. Po ashtu dyshojmë se e mungon ndonjë profil i caktuar.

Nuk na është lejuar të shohim dosjen e aktivitetit financiar përkatësisht qarkullimet kompanisë, prandaj dyshojmë se kompania mund të mos ketë referencat e duhura sipas kërkesës.

Nuk na është lejuar të shohim zgjedhjen teknike për aplikacionin, prandaj dyshojmë se edhe nuk e ka fare. PO ashtu nuk shihet se si subjekti planifikon të dëshmojë zgjedhjen teknike me theks të veçantë se si do demonstroj në 90% njohjen e grupit të shqipe.

Sqarimet janë kërkuar në mënyrë kundërligjore në lidhje me deklaratën për mirëmbajtje sepse ka qenë e qartë mospërputhja e ofrimit të periudhës së mirëmbajtjes.

Po ashtu është favorizuar OE i rekomanduar për kontratë edhe sa i përket platformës së testimit, prandaj dyshojmë se kërkuesit janë kërkuar sqarime, sepse me sqarime secili OE pranon se posedon platformë testimi. Ky OE është dashur të eliminohet pa kërkuar sqarime fare, prandaj në këtë rast neni 5 dhe 72 është përdorur në mënyrë favorizuese në raport me OE të rekomanduar për kontratë.

Të gjitha këto dyshime tonë, kërkojmë që ti verifikoni dhe të analizoni edhe njëherë dosjen e OE të rekomanduar për kontratë në të kundërtën ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën e ankimit edhe për shkelje të nenit 10 dhe 11 të LPP-së.

Neve nuk na është lejuar qasja e plotë në dokumentet e OE të lartcekur, përkatësisht dokumentet si: Qarkullimet bankare, stafi i kompanisë, projektet e realizuara, planin dinamik dhe propozimin teknik.

Pra ne dyshojmë se OE i lartcekur është i papërgjegjshëm, pasi që nuk i ka përmbushur gjatë gjithë kohës kërkesat e dosjes së tenderit përkatësisht kërkesat për kapacitetin ekonomik, financiar, kapacitetin teknik dhe profesional dhe gjithashtu edhe specifikimet teknike.

Edhe OE “PBC SHPK” ka plotësuar aneksin 3 Kërkesa për sekret afarist, prandaj mungesë të shikimit të dokumentacionit të këtij OE duhet të ngritim pretendime me dyshim. Konsiderojmë se ky OE është i papërgjegjshëm me arsyet si në vijim:

Lista e stafit nuk përmbush kërkesën e dosjes së tenderit dhe stafi i ofruar nuk ka përvojë të kërkuara sipas dosjes së tenderit.

Stafi i angazhuar nuk kanë ofruar dëshmi për referenca, diploma, certifikata, apo kontrakt, prandaj stafi nuk përmbush kriteret sipas dosjes së tenderit por dyshojmë se mungon e ndonjë profil i caktuar.

Dosja e aktivitetit financiar të kompanisë nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Dyshojmë se kompania nuk ka referencat e duhura sipas kërkesës.

Nuk kemi pasur qasje në zgjedhjen teknike për aplikacionin, prandaj dyshojmë se mund të jetë e pamundur të tregojmë se si subjekti planifikon të dëshmojë zgjedhjen teknike apo nuk është adekuate. Nuk shihet se si subjekti planifikon të dëshmojë zgjedhjen teknike me theks të veçantë se si do demonstrojë në 90% njohjen e gjuhës shqipe.

OE TECH VISION SH.PK; EDUSOFT, është i papërgjegjshëm ashtu siç e ka caktuar AK-së:

Ju nuk keni plotësuar kërkesat siç është kërkuar në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Tek Kërkesat mbi mundësitë teknik edhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 pika 3.2 Minimum një (1) arkitekt të sistemit – personi i rekomanduar për këtë pozitë me CV dhe dëshmitë e ofruara nuk e përmbushë kërkesën e cekur në dosje të tenderit, tek pika 3.8 Minimum një (1) Testues Softueri - personi i rekomanduar për këtë pozitë me CV dhe dëshmitë e ofruara nuk e përmbushë kërkesën e cekur në dosje të tenderit, tek pika 3.6 Minimum një (1) ekonomist – edhe pse në CV i shkruan që është i certifikuar si kontabilist me gjithë mangësitë e ofertës cekura më lartë komisioni i vlerësimit nuk e ka parë të arsyeshme që të kërkojë sqarime shtesë.

Prandaj bazuar në të dhënat gjetur dhe në bazë të UDHËZUES Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK neni 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve citoj:

CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69
--	---	----

sipas komisionit të vlerësimit kjo ofertë konsiderohet si ofertë e papërgjegjshme.

OE “Protecht SHPK është i papërgjegjshëm ashtu siç e ka caktuar AK-së:

Ju nuk keni plotësuar siç duhet Formularin e Tenderit, gjithashtu nuk keni dorëzuar me ofertë Sigurimin e Tenderit siç është kërkuar në dosje të tenderit dhe njoftim për kontratë.

Në bazë të UDHËZUES Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK neni 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve citoj:

Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ
--	---	---------------------

Sigurimi i Tenderit mungon apo nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjese e DT	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	57
--	---	----

OE Komtel Project&Engineering SHPK është i papërgjegjshëm ashtu siç e ka caktuar AK-së:

Ofetra juaj nuk i ka plotësuar kërkesat siç është kërkuar në dosje të tenderit dhe në njottimin per kontratë.

Tek Kërkesat mbi mundësitë teknik edhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kërkesa numër 3 pika 3.1 3.1
Një (1) Menaxher / udhëheqës të projektit i cili duhet të ketë të përfunduar fakultetin e Inxhinierisë kompjuterike, Kompjuterikë me telekomunikacion ose shkencë kompjuterike dhe i njëjti të ketë përvojë min. 5 vite në menaxhimin e projekteve të ngjashme (projekteve softuerike);

Ju nuk keni arritur që ta plotësoni plotësisht këtë kërkesë pasi që nuk keni dorëzuar vendimin mbi caktimin e menaxherit te projektit,
Dëshmitë për kërkesën nr.3 –

Për stafin udhëheqës profesional OE duhet të ofroj dëshmi si në vijim:

Vendimin për caktimin e menaxherit të projektit, CV-të, Referencat mbi përvojën e kërkuar, Diploma (për pikat 3.1 dhe 3.3 ose Certifikata nga Microsoft, për piken 3.4 pos diplomës duhet të ofrohet edhe Certifikata, për piken 3.6 pos diplomës duhet të ofrohet edhe Certifikata si kontabilist i certifikuar nga tjëra nga shoqatat të akredituara për certifikimin e kontabilistëve), Kontratat e punës me punëdhënësin ose marrëveshjet mbi angazhimin për këtë projekt.

Gjithashtu ju nuk i keni plotësuar në tërësi edhe Kërkesa numër 2

Operatori ekonomik duhet të dorëzoj listën e stafit kyç të cilët do ti angazhoi në këtë projekt.
Dëshmitë për kërkesën nr. 2

Lista e dorëzuar nga operatori ekonomik mbi stafin e angazhuar duhet ti ketë emrat e stafit dhe rolin /pozitën që do të angazhohen në këtë projekt. Lista duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur.

Lista e stafit e dërguar nga OE nuk është e nënshkruar as e vulosur.

**Ju nuk i keni plotësuar në tërësi edhe pikat
Dëshmitë për kërkesën nr.3 –**

Për stafin udhëheqës profesional OE duhet të ofroj dëshmi si në vijim:

Vendimin për caktimin e menaxherit të projektit, CV-të, Referencat mbi përvojën e kërkuar, Diploma (për pikat 3.2 dhe 3.3 ose Certifikata nga Microsoft, për piken 3.4 pos diplomës duhet të ofrohet edhe Certifikata, për piken 3.6 pos diplomës duhet të ofrohet edhe Certifikata si kontabilist i certifikuar nga njëra nga shoqatat të akredituara për certifikimin e kontabilisteve), Kontratat e punës me punëdhënësin ose marrëveshjet mbi angazhimin për këtë projekt.

gjithashtu nënshkruesi i dokumenteve të ofertës nuk është një person i autorizuar nuk e ka të bashkangjitur autorizimin nga pronari dhe në ARBK nuk figuron tek personat e autorizuar . Duke qenë se ju jeni eliminuar për piken e cekur më lartë dhe meqenëse nuk keni qenë oferta me çmimin më të lirë komisioni i vlerësimit nuk e ka pa të arsyeshme të kërkoj sqarime shtesë.

Nga faktet dhe argumentet që u cekën në këtë kërkesë për rishqyrtim kuptohet që OE ka bërë kërkesë për sekret afarist ndërsa nenit 11 e obligon autoritetin kontraktues që të vendosë se cilat dëshmi mund të konsiderohen sekret afarist, e jo ti merren si obligim kërkesat e qara që i gjithë dokumentacioni siç e cekëm më lartë të cilësohet si sekret afarist. Pra AK-ja në këtë veprim nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 10 dhe 11 të LPP-së për qasje të dokumenteve dhe për përdorimin e versionit të pastruar të dokumenteve, duke i favorizuar të rekomanduar për kontratë dhe OE tjerë që e kanë plotësuar aneksin 3.

Gjithashtu duhet cekur fakti se në raportin e vlerësimit i cili na është dhënë gjatë qasjes të dokumenteve nuk figuron askund nënshkrimi i anëtarëve të komisionit vlerësues, andaj ky fakt na bën të dyshojmë që ky raport nuk është përgatitur nga persona profesional për këtë funksion të prokurimit.

Me dt.30.11.2023 ne kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-se sa i përket kërkesës për rishqyrtim ku e njëjta e ka refuzuar si të pa bazuar.

AK-ja ne arsyetimin e saj nuk ka dhënë asnjë përgjigje konkrete si dhe asnjë arsye të bazuar se njoftimi mbi vendimin e AK-së ka qenë i drejtë dhe në pajtueshmëri me dispozitat ligjore të LPP-së.

Në kërkesë për rishqyrtim siç e kemi cekur edhe më lartë në ankesë kemi parashtruar pretendimet tona ankimore duke u bazuar në dyshime, për faktin se autoriteti kontraktues nuk na ka lejuar qasje të plotë në dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë, arsye të arsyetimit se i njëjti i ka deklaruar si sekret afarist shumicën e dokumenteve të tij.

AK-ja në vendimin për refuzim nuk ka dhënë asnjë arsyetim konkret sa i për pretendimeve tona ankimore, mirëpo vetëm e ka cekur se kinse i ka respektuar dispozitat neneve të kontestuara nga ne.

Në lidhje me pretendimin tonë ankimor për shkelje të nenit 10 dhe 11 të LPP-së, e njëjti ka cekur se ka bërë versionin e pastruar të dokumenteve dhe konstatimet se cilat dokumente janë sekret afarist e cilat jo, i ka bazuar në nenin 11.4 të LPP-së.

AK-ja nuk ka vepruar në këtë mënyrë siç ka pretenduar, pasi që në këtë rast nuk mund të deklarohen si sekret afarist dokumentet në lidhje me kontratat, stafin, përvojën e punës dhe dokumentet tjera, pasi që të njëjtat nuk janë dokumente që duhet të konsiderohen konfidenciale, sepse nëse zbulohen këto dëshmi nuk dëmtohet fare kompania fituese.

Njëkohësisht OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dhënë asnjë arsyetim të bazuar dhe dëshmuar siç kërkohet në paragrafin 3.3 të nenit 11 të LPP-së se si dhe përse mund të shkaktojë dëm material zbulimi apo qasja në dokumentet që i ka konsideruar sekret afarist.

Autoriteti kontraktues e ka cekur se është bërë versioni i pastruar i dokumenteve dhe se janë dhënë dokumentet, me përjashtim të dokumenteve që kanë të bëjnë me nenin 68 dhe të LPP-së, sipas kërkesës së OE të rekomanduar për kontratë, mirëpo neve nuk na janë ofruar dokumentet që e përbëjnë pjesën kryesore të tenderit dhe prej të cilave varet përgjegjshmëria e operatorëve ekonomik.

Në lidhje me arsyetimin e lartcekur ju sqarojmë se edhe përkundër faktit që OE kanë bërë kërkesë për sekret afarist, neni 11 e obligon autoritetin kontraktues që të vendos se cili dokument mund të konsiderohen sekret afarist, e jo ti merr obligativisht kërkesat e OE që të gjithë dokumentacioni siç e cekëm më lartë të cilësohet si sekret afarist. Edhe pse AK-ja e ka cekur se kinse ka bërë versionin e pastruar, ne ju sqarojmë edhe një herë se nuk mund të konsiderohet i gjithë dokumentacioni në lidhje me kapacitetin teknik dhe profesional sekret afarist dhe se nuk është përgatitur versioni i pastruar konform Rregullativës ligjore dhe konform praktikave më të mira ndërkombëtare.

Me këtë veprim AK-ja e ka favorizuar haptas OE e rekomanduar për kontratë dhe OE tjetër i cili është shpallur si tenderues i pasuksesshëm, pasi që i ka lejuar dhe faktikisht i ka pranuar pothuajse të gjithë dokumentacionin si sekret afarist.

Sa i përket pretendimit tonë ankimore në lidhje me propozimin teknik për projektin prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë, AK-ja është munduar të arsyetohet duke cekur se propozimi teknik nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit dhe si i tillë nuk ka qenë pjesë e vlerësimit edhe pse OE-të kanë ofruar një propozim të tillë.

Vet fakti që OE të cilët kanë ofertuar, e kanë prezantuar propozimin teknik, kuptohet që se arsyetimi i autoritetit kontraktues është i pa qëndrueshëm, sepse nëse nuk do të kërkohej propozimi teknik atëherë OE nuk do ta ofronin fare një propozim të tillë.

Sa i përket arsyetimit të AK-së, ku e njëjta e ka cekur se komisioni i vlerësimit të ofertave ka qenë i përbërë prej 3 anëtarëve ku dy prej tyre kanë qenë nga njësia e kërkesës KPM. Ne ju sqarojmë se edhe ky arsyetim i AK-së për ne është i pa bazuar. Ne e kemi cekur qartë në raportin i komisionit vlerësues që na është prezantuar nga ana e AK-së, nuk ka asnjë nënshkrim nga ana e anëtarëve të komisionit, andaj kemi parashtruar pretendimin se i njëjti raport nuk është përgatitur nga zyrtar profesional. Në lidhje me këtë pretendim tonë ankimor AK-ja ka dhënë arsyetimin siç e cekëm më lartë, mirëpo duke mos na ofruar dëshmi të nënshkrimit të raportit, ne përveç se dyshojmë që i njëjti nuk është përgatitur nga zyrtar profesional, njëkohësisht dyshojmë që edhe vet anëtarët nuk janë pajtuar me rekomandimin për kontratë të OE që është rekomanduar për kontratë.

Andaj kërkojmë nga eksperti shqyrtues i OSHP-së dhe paneli shqyrtues të na e sqarojnë fakte konkrete se anëtarët e komisionit kanë qenë persona kompetent për një vlerësim të tillë dhe se a është nënshkruar raporti i komisionit nga të gjithë anëtarët.

Autoriteti kontraktues në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim i është referuar nenit 56.3 sa i përket pretendimeve tona ankimore kundrejt propozimit teknik të OE rekomanduar për kontratë. Ky arsyetim i autoritetit kontraktues e tregon qartë favorizimin që po i bëhet OE të rekomanduar për kontratë, pasi që mos përmbushja e specifikimeve teknike nuk mund dhe nuk duhet të arsyetohet në asnjë mënyrë.

Sa i përket sqarimeve që i janë kërkuar OE të rekomanduar për kontratë dhe të cilat siç është përmendur në AK-së kanë qenë bindëse, ju sqarojmë se edhe ky arsyetim i të njëjtës është i pa bazuar dhe i paqëndrueshëm.

OE i rekomanduar për kontratë në përgjigjet e tij në kërkesën për sqarime e tregon qartë papërgjegjshmërinë e tij, mirëpo që AK-ja nuk e ka marr parasysh fare këtë gjë, ku për

fakteve që po ju prezantojnë më poshtë po vërtetohen pretendimet tona ankimore vlerësimi i ofertave nuk është bërë nga persona kompetent/profesional.

Tek përgjigja nr.2, OE i rekomanduar për kontratë ka dhënë sqarimin si në vijim:

- spaCy: SpaCy është një bibliotekë e njohjes natyrore e pasur dhe e specializuar shumë gjuhë, duke përfshirë edhe shqipen. Kjo bibliotekë ofron analiza morfologjike, analizë sintaksore, dhe shërbime tjera për trajtimin e tekstit në gjuhë shqipe.

Ky konstatim i OE të rekomanduar për kontratë është i paqëndrueshëm sepse spaCy përdoret për njohjen e gjuhës siç pretendon OE i rekomanduar për kontratë, mirëpo përdoret për përdorime të modeleve gjuhësore, domethënë nuk përdoret për një space speech recognition

- NLTK (Natural Language Toolkit): NLTK është një bibliotekë e njohjes së gjuhës natyrore të zhvilluar në Python. Ajo ofron mjetet dhe burimet e nevojshme për analizën e tekstit shqip dhe për zhvillimin e aplikacioneve të ndryshme të bazuar në gjuhën natyrore

Gjithashtu edhe NLTK nuk përdoret për speech recognition, por përdoret për manipulim të gjuhësore dhe si e tillë nuk e zgjidh problemin e speech recognition.

- Hugging Face Transformers: Hugging face ofron një koleksion të madh të modeleve të mësimi automatik të gjuhës natyrore të shqipes. Ky resurs është i dobishëm për përdorim të modeleve të gatshme për punë me tekst në gjuhën shqipe ose për të zhvilluar modele të personalizuar për detyra të veçanta

Po ashtu ju sqarojmë se edhe konstatimi i lartcekur i OE të rekomanduar për kontratë, është i qëndrueshëm për faktin se Hugging Face Transformers është emri i kompanisë cila ka të bëjë me menaxhimin e modeleve të inteligjencës artificiale por nuk është specifikuar për njohjen e gjuhës së folur dhe kthimin e saj në gjuhë të shkruar, siç është kërkuar në dokumentin e tenderit.

Pra duke u bazuar në faktet e lartcekura, kuptohet qartë se përgjigjet e OE të rekomanduar për kontratë nuk janë analizuar në tërësi nga ana e AK-së, mirëpo vetëm i janë marrë parasysh pa i analizuar fare dhe ky veprim i AK-së tregon qartë favorizimin që po i bëhet OE të rekomanduar për kontratë.

Gjithashtu AK-ja në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, e ka cekur se kërkuar sqarime OE të rekomanduar për kontratë edhe në lidhje me çmimin me të cilin ofertuar, pasi që sipas nenit 41.3 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik tendë të njëjtit është jo normalisht i ulët, mirëpo që nuk na ka dhënë as këtë dokument sepse përgjigjjen e OE ka pasur elemente të nenit 68 dhe 69 të LPP-së. Me vet faktin që OE rekomanduar për kontratë nuk e ka deklaruar edhe përgjigjjen si sekret afarist, mirëpo AK-ja ka deklaruar se ka përmbajtur elemente të nenit 68 dhe 69 të LPP-së, ky arsyetim njëjtës po e tregon qartë favorizimin që po i bëhet OE të rekomanduar për kontratë nga e AK-së.

Autoriteti kontraktues nuk i ka shqyrtuar fare pretendimet tona në lidhje me OE “P SHPK”, i cili është shpallur si tenderues i pasuksesshëm, ndërsa me këtë veprim edhe herë po e tregon qartë diskriminimin që po i bën kompanisë tonë, si OE i vetë përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura, kuptohet qartë se vendimi i AK-së refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i pa qëndrueshëm dhe njëkohësisht i pa mbështetur në dispozita ligjore, mirëpo është vendim që favorizon OE të rekomanduar për kontratë.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë konstatojmë ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 5 LPP-së, sepse është rekomanduar për kontratë OE i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe te njoftimit për kontratë dhe njëkohësisht nuk është respektuar e kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Në këtë tender vetëm ne jemi OE i përgjegjshëm, prandaj është dashur të shpallemi fitues. Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, sepse ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë dhe nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “*Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të vepronte në mënyrë transparente*”. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që “*Gjithëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse*”, mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur asnjë dispozite ligjore duke e rekomanduar për kontratë një OE të papërgjegjshëm.

Gjithashtu autoriteti kontraktues është dashur të kete në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjatësi të fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Në fund kërkojmë që të analizohet në tërësi oferta e OE të rekomanduar për kontratë se a i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë të detyrohet AK-së që të na jep qasje të plotë në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë dhe të OE tjerë të cilat kanë deklaruar sekret afarist tërë ofertat e tyre.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u përmendën më lartë, kërkojmë nga OSJ që të merr:

VENDIM

APROVOHET ankesa e OE **Quantix L.L.C.** si e bazuar,
ANULOHET njoftimi mbi vendimin (B58) e AK-së, për dhënie të kontratës si dhe lëndë kthehet në

RIVLERËSIM,

DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, në vlerë prej 5,000.00 euro.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional Kërkesa numër 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses shërbime të ngjashme gjatë tri viteve të shkuara deri në publikimin e këtij njoftimi për kontratë në vlerë jo me	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> Dëshmitë për kërkesën nr.1 Listën e projekteve për shërbime të ngjashme të nënshkruar dhe vulosur (originalin) për periudhën e shkuar trevjeçare, duke treguar vlerën, datën, natyrën e shërbimeve. duke ia
		pak se 200,000.00 Euro Kërkesa numër 2 Operatori ekonomik duhet të dorëzoj listën e stafit kyç të cilët do ti angazhojnë në këtë projekt.	bashkangjitur referencat ose raportet e pranimit të shërbimeve. Bazuar në LPP në fuqi, Neni 69 Aftësia Teknike dhe ose Profesionale, pika 2.1. (ii) kur punët janë kryer për një subjekt privat, për dëshmi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe ofruesi i shërbimeve që evidenton një livrim të tillë. Dëshmitë për kërkesën nr. 2 Lista e dorëzuar nga operatori ekonomik mbi stafin e angazhuar duhet të ketë emrat e stafit dhe rolin /pozitën që do të angazhohen në këtë projekt. Lista duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur.

	<p>Kërkesa numër 3</p> <p>Operatori ekonomik duhet të ofrojë staf profesional udhëheqës / përgjegjës drejtpërdrejtë për realizimin e projektit si në vijim:</p> <p>3.1 Një (1) Menaxher/udhëheqës të projektit i cili duhet të ketë të përfunduar fakultetin e Inxhinierisë kompjuterike, Kompjuterikë me telekomunikacion ose shkencë kompjuterike dhe i njëjti të ketë përvojë min. 5 vite në menaxhimin e projekteve të ngjashme (projekteve softuerike);</p> <p>3.2 Minimum një (1) arkitekt të sistemit i cili duhet të ketë të përfunduar fakultetin e Inxhinierisë kompjuterike, Kompjuterikë me telekomunikacion, Shkencë kompjuterike ose të jetë i certifikuar nga Microsoft dhe i njëjti të ketë përvojë min. 5 vite si arkitekt në projekte softuerike të ngjashme.</p>	<p>Dëshmitë për kërkesën nr.3 –</p> <p>Për stafin udhëheqës profesional OE duhet të ofroj dëshmi si në vijim:</p> <p>Vendimin për caktimin e menaxherit të projektit, CV-të, Referencat mbi përvojën e kërkuar, Diploma (për pikat 3.2 dhe 3.3 ose Certifikata nga Microsoft, për pikën 3.4 pos diplomës duhet të ofrohet edhe Certifikata, për pikën 3.6 pos diplomës duhet të ofrohet edhe Certifikata si kontabilist i certifikuar nga njëra nga shoqatat të akredituara për certifikimin e kontabilistëve), Kontratat e punës me punëdhënësin ose marrëveshjet mbi angazhimin për këtë projekt.</p>
--	--	--

		<p>3.3. Minimum një (1) analist i sistemeve softuerike i cili duhet të ketë të përfunduar fakultetin e Inxhinierisë kompjuterike, Kompjuterikë me telekomunikacion, Shkenca kompjuterike ose të jetë i certifikuar nga Microsoft dhe i njëjti të ketë përvojë min. 5 vite në analizimin e platformave softuerike të ngjashme.</p> <p>3.4. Minimum një (1) Devops i cili duhet të ketë të përfunduar fakultetin e Inxhinierisë kompjuterike,</p>	
		<p>Kompjuterikë me telekomunikacion ose shkenca kompjuterike dhe i njëjti të ketë përvojë min. 5 vite në përfomimin e detyrave kritike të IT-së duke përfshirë konfigurimin e pajisjeve, rikuperimin e të dhënave, konfigurimin e sistemeve. Të ketë shkollim/certifikim shtesë se paku Certifikatën CompTIA A+ ose të ngjashme.</p> <p>3.5. Minimum katër (4) zhvillues të softuerëve të cilët duhet të kenë të përfunduar fakultetin e Inxhinierisë kompjuterike, Kompjuterikë me telekomunikacion ose shkenca kompjuterike dhe të njëjtut duhet të kenë përvojë min. 5 vite në zhvillimin e softuerëve të ngjashëm.</p>	

		<p>3.6 Minimum një (1) ekonomist i cili duhet të ketë të përfunduar fakultetin Ekonomik dhe të jetë kontabilist i certifikuar i njëjti duhet të ketë min. 5 vite përvojë pune në financa / kontabilitet.</p> <p>3.7 Minimum një (1) dizajner të sistemeve softuerike i cili duhet të ketë të përfunduar fakultetin në dizajn grafik ose art vizual dhe i njëjti duhet të ketë min. 3 vite përvojë në dizajnim e projekteve softuerike të ngjashme.</p> <p>3.8 Minimum një (1) Testues Softueri - Siguruesi i Kualitetit dhe Kontrollues i Kualitetit i cili duhet të ketë të përfunduar fakultetin e Inxhinierisë kompjuterike, Kompjuterikë me telekomunikacion ose shkenca kompjuterike dhe i njëjti duhet të ketë min. 5 vite përvojë në testimin e kualitetit dhe sigurisë në aplikacione softuerike të ngjashme.</p>	
--	--	---	--

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

--

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Quantix L.L.C.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Krijimi i sistemit elektronik të proceseve për nevojat e Komisionit të Pavarur për Media E-KPM-ja” me numër të prokurimit: “UA/2016-23-9009-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia Qendrore e Prokurimit

Nr:	Grupi:
1	Krijimi i sistemit elektronik të proceseve për nevojat e Komisionit të Pavarur për Media E-KPM-ja
	Emri i tenderuesit të suksesshëm
	Kodi postar
	Adresa
	"DataProgNet" SH.P.K., 810131318
	70000
	Rr. Qamil Ilazi, Nr.16

DEKLARATË

Pas ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertave, komisioni i vlerësimit ka evidentuar se ne aktivitetin e prokurimit: **Krijimi i sistemit elektronik të proceseve për nevojat e Komisionit të Pavarur për Media E-KPM-ja** dhe me numër të prokurimit **UA/2016-23-9009-2-1-1** kanë ofertë gjashtë (6) operatorë ekonomik. Gjatë vlerësimit të ofertave komisioni i vlerësimit ka konstatuar se operatorët ekonomik:

PBC SH.P.K. - Ka plotësuar të gjitha kërkesat teknike dhe profesionale të cekura në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë, mirëpo shkak që nuk është çmimi me I lire I ofertës nuk është rekomanduar për kontratë.

Quantix L.L.C. - Ka plotësuar të gjitha kërkesat teknike dhe profesionale të cekura në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë, mirëpo shkak që nuk është çmimi me I lire I ofertës nuk është rekomanduar për kontratë.

TECH VISION SH.P.K. – Ofetra e OE nuk I ka plotësuar kërkesat sic është kërkuar në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Tek Kërkesat mbi mundësitë teknik edhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 pika 3.2 Minimum një (1) arkitekt të sistemit – personi i rekomanduar për pozitë me CV dhe dëshmitë e ofruara nuk e përmbushë kërkesën e cekur në dosje të tenderit, tek pika 3.8 Minimum një (1) Testues Softueri personi i rekomanduar për këtë pozitë me CV dhe dëshmitë e ofruara nuk e përmbushë kërkesën e cekur në dosje të tenderit, tek pika 3.6 Minimum një (1) ekonomist – edhe pse në CV i shkruan që është i certifikuar si kontabilist me gjithë mangësitë e ofertës nuk e kemi parë të arsyeshme që të kërkojmë sqarime shtesë. Prandaj bazuar në të dhënat gjetur sipas komisionit të vlerësimit kjo ofertë konsiderohet si ofertë papërgjegjshme

Activated Windows

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

PO

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - Quantix L.L.C.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues

Sqarim hyrës:

Agjencia Qendrore e Prokurimit si Autoritet Kontraktues (AK) me datë 21.11.2023 ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së ku ka rekomanduar për kontratë OE Data Prognat Sh.p.k. OE ankues me datë 27.11.2023 ka paraqitur kërkesën për rishqyrtim në AK. Përderisa AK me datë 30.11.2023 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

Pretendimi ankimor 1

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim dispozitat e LPP-së duke mos i lejuar qasje të plotë në dokumentet e tenderit të OE të rekomanduar për kontratë.

Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 1

Pas njoftimit mbi vendimin e AK-së të datës 21.11.2023 ku është rekomanduar për kontratë OE *DataProgNet*. OE ankues me datë 23.11.2023 përmes emailit ka kërkuar qasje në dokumentet tenderuese të gjithë OE-ve që kanë marrë pjesë në këtë aktivitet dhe në raportin e vlerësimit përfshirë të gjithë dokumentet që ndërlidhen me vlerësimin.

Në të njëjtën ditë, AK përmes emailit ka informuar OE ankues që mund të kenë qasje nga ora 14:30 në AK. Në lidhje me qasjen, AK ka përpiluar procesverbalin në të cilin shënohet: *Kërkesa e operatorit ekonomik: Quantix L.L.C., ju lejua qasja në ofertat e operatoreve ekonomik: Data Prognat Sh.p.k, Tech Vision Sh.p.k , OE PBC Sh.p.k , Komtel Project Enginiering Sh.p.k, Protecht Sh.p.k;. Ofertat ju dorëzuan përmes një USB-e, Operatorët ekonomik DataProgNet SH.P.K."; TECH VISION SH.P.K." dhe " PBC SH.P.K." kanë deklaruar si sekret afarist dokumentet në baze të nenit 68 dhe 69 të LPP-se. AK duke u bazuar në nenin 11 të LPP-se paragrafi 4 juve iu është ofruar versioni i pastruar i dokumenteve, pjesa e mbetur e ofertave të tyre janë të ngarkuara në USB. Dokumenti është i nënshkruar nga përfaqësuesi i OE dhe AK-së.*

OE ankues përsëri me datë 24.11.2023 ka dërguar email në lidhje me qasjen, me tekstin si vijon:

Dje kemi kërkuar dokumentet tenderuese për projektin me titull: Krijimi i sistemit elektronik të proceseve për nevojat e Komisionit të Pavarur për Media / E-KPM-ja, me nr.te prokurimit: UA/2016-23-9009-2-1-1 - AQP-AK-23-051-211, te te gjithë operatoreve ekonomik qe kane marre pjese ne këtë aktivitet, mirëpo dosjet e dy operatoreve te përgjegjshëm DataPrognat dhe PBC nuk janë të plota, ne to mungojnë te gjitha dokumentet qe vërtetojnë kapacitetin teknik dhe financiar: Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses shërbime të ngjashme gjatë tri viteve të shkuara deri në publikimin e këtij njoftimi për kontratë në vlerë jo me pak se 200,000.00 Euro. Listën e projekteve për shërbime të ngjashme të nënshkruar dhe vulosur (origjinalin) për periudhën e shkuar trevjeçare, duke treguar vlerën, datën, natyrën e shërbimeve. duke ia bashkangjitur referencat ose raportet e pranimit te shërbimeve.

Lista e dorëzuar nga operatori ekonomik mbi stafin e angazhuar duhet ti ketë emrat e stafit dhe rolin /pozitën që do të angazhohen në këtë projekt. Lista duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur.

Te gjitha Kërkesat për stafin 3.1 - 3.8. Poashtu ne raport te vlerësimit specifikohet qe është kërkuar shpjegim shtese nga operatori fitues me dt 01/11/2023 dhe me dt 02/11/2023 keni pranuar përgjigje, por as nuk specifikohet çka është kërkuar apo as çka ka qene përgjigja dhe se as nuk ka dokumente te bashkangjitura për ketë!! Ju lusim te na mundësoni qasje ne dosjen e plote. Paraprkisht, Ju faleminderit

Me datë 27.11.2023, AK ka kthyer përgjigje OE ankues me tekstin si vijon: *Juve ju është dhënë qasja menjëherë pas kërkesës suaj. Siç e keni të cekur edhe në procesverbalin e pranimit të qasjes se dokumenteve, OE-të në fjalë kanë plotësuar Aneksin 3 (KËRKESA PËR SEKRET AFARIST).*

Sipas Neni 11 Informatat Sekrete Afariste të LPP-së juve ju është dhënë versioni i pastruar i ofertave. Citim paragrafët e këtij neni: 3. Autoriteti kontraktues mund t'i klasifikojë informatat e tjera si informatë sekrete afariste vetëm nëse informata përkatëse i përmbushë këto tri kritere:

3.1 që atë ta ketë dërguar një operator ekonomik në përputhje me kërkesën e përcaktuar nga autoriteti i tillë kontraktues sipas nenit 68 ose 69 të këtij ligji;

4. Autoriteti kontraktues që e ka klasifikuar një element të informatës si informatë sekrete afariste sipas paragrafit 3. të këtij neni, do të përgatit versionin e “pastruar” të çdo dokumenti, nëse elementi i tillë gjendet në dokumentin në të cilin po ashtu gjendet informacioni që nuk konsiderohet të jetë sekret. Versioni i tillë i pastruar duhet të përfshihet në materialin në të cilin ka qasje publiku dhe palët e interesuara sipas nenit paragrafit 3. të nenit 10 të këtij ligji. Autoriteti kontraktues do të bashkëngjisë në ballinë të versionit të tillë të pastruar një njoftim që thotë se (i) autoriteti kontraktues i ka klasifikuar disa elemente të caktuara të informatës në dokumentin origjinal si informata sekrete afariste, me kërkesën e operatorit përkatës ekonomik, dhe (ii) versioni i pastruar i bashkangjitur është përgatitur nga autoriteti kontraktues dhe është një kopje e saktë e origjinalit pas heqjes ose fshirjes së informatave të tilla sekrete afariste. Sa i përket kërkesës suaj për qasje në sqarimet e tenderit ato do ti bashkëngjisim në këtë emali. Me email AK ka bashkangjitur edhe Letrën standarde të kërkesës për sqarimin e tenderit të datës 01.11.2023, si dhe dokumentin Përgjigje ndaj kërkesës - B47 Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit të dërguar nga OE DataProgNet SH.P.K.

OE ankues me datë 27.11.2023 si palë e pakënaqur me vendimin e AK-së ka dorëzuar kërkesë për rishqyrtim në AK, me pretendimin e njëjtë ankimor si në këtë ankesë.

AK me datë ka marrë vendim për refuzimin e kërkesë për rishqyrtim me arsyetimin si vijon: *Duke ju përgjigjur pretendimeve tuaja që AK nuk ka vepruar sipas nenit 10 dhe 11 të LPP-së ju rikujtojmë edhe njëherë siç ju kemi sqaruar edhe ne email te datës 27.11.2023 se AK ka vepruar konform ligjeve dhe rregullave të prokurimit publik në fuqi. Juve ju është dhënë qasja menjëherë pas kërkesës suaj. Siç e keni të cekur edhe në procesverbalin e pranimit të qasjes së dokumenteve, OE-te në fjale kanë plotësuar Aneksin 3 (KERKESA PER SEKRET AFARIST). Sipas Neni 11 Informatat Sekrete Afariste të LPP-se juve ju është dhënë versionin i pastruar i ofertave.*

Eksperti shqyrtues dhe teknik kanë verifikuar se OE ankues në tenderin e tij ka dorëzuar kërkesën për sekret afarist të nënshkruar dhe vulosur me përmbajtjen si vijon: *Ne ofertën*

teknike dhe financiare me nr. te prokurimit: UA/2016-23-9009-2-1-1 e dorëzuar nga DataProgNet SH.P.K me dt. 02.10.2023 te mbahen sekrete ndaj çfarëdo kërkesë te ndonjë Operatori ekonomik për qasje zyrtare këto pjese: Stafit i Kompanisë, Projektet e realizuara me vlera, Planin dinamik dhe Propozimi teknik. Në lidhje me këtë kërkesë është dhënë arsyetimi s vijon: Deklarojmë se dhënia e qasjeve ne pikat e cekuar me sipër ndonjë Operatori ekonomik, e dëmton prestigjin e kompanisë sonë dhe jemi te detyruar te padisim Agjencinë Qendrore te Prokurimit, në gjykatat kompetente për mos ruajtje te sekretit afarist.

Vlerësimi i ekspertit shqyrtues dhe teknik lidhur me pretendimin ankimor 1

Eksperti Shqyrtues dhe teknik sqarojnë se AK ka vepruar në pajtim me parimet dhe dispozitat e LPP-së duke siguruar qasje të arsyeshme OE ankues dhe në të njëjtën kohë ka zbatuar kërkesat e nenit 11 duke mbajtur si sekret informatat e klasifikuara si informata sekrete afariste nga OE i rekomanduar. Megjithatë, AK gjatë klasifikimit të informatave sipas kërkesës së OE të rekomanduar është dashur që të bëjë analizimin në kuptimin që kontratat dhe referencat e lëshuara nga një autoritet publik të mos i klasifikojë si informatat sekrete afariste. Kjo për faktin se nga 12 kontratat e prezantuara në listën e kontratave 10 prej tyre janë kontrata të lidhura ndërmjet OE të rekomanduar për kontratë me institucione publike. Andaj, pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi ankimor 2

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë nuk përmbush kërkesat 2 dhe 3 të kapacitetit teknik dhe profesional. Pretendimi është bërë mbi bazën e supozimit pa kontestuar një kërkesë apo dëshmi specifike.

Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 2

AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, përkatësisht kapaciteti teknik dhe profesional, ka vendosur kërkesën 2 si vijon: “Operatori ekonomik duhet të dorëzoj listën e stafit kyç të cilët do të angazhoi në këtë projekt”. Në lidhje me këtë kërkesë dëshmia dokumentare e kërkuar është: “Lista e dorëzuar nga operatori ekonomik mbi stafin e angazhuar duhet të ketë emrat e stafit dhe rolin /pozitën që do të angazhohen në këtë projekt. Lista duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur”. Më tej AK ka vendosur kërkesën numër 3 Operatori ekonomik duhet të ofrojë staf profesional

udhëheqës / përgjegjës drejtpërdrejtë për realizimin e projektit si në vijim: “3.1 Një (1) Menaxher/udhëheqës të projektit i cili duhet të ketë të përfunduar fakultetin e Inxhinierisë kompjuterike, Kompjuterikë me telekomunikacion ose shkencë kompjuterike dhe i njëjti të ketë përvojë min. 5 vite në menaxhimin e projekteve të ngjashme (projekteve softuerike); 3.2 Minimum një (1) arkitekt të sistemit i cili duhet të ketë të përfunduar fakultetin e Inxhinierisë kompjuterike, Kompjuterikë me telekomunikacion, Shkencë kompjuterike ose të jetë i certifikuar nga Microsoft dhe i njëjti të ketë përvojë min. 5 vite si arkitekt në projekte softuerike të ngjashme. 3.3. Minimum një (1) analist i sistemeve softuerike i cili duhet të ketë të përfunduar fakultetin e Inxhinierisë kompjuterike, Kompjuterikë me telekomunikacion, Shkencë kompjuterike ose të jetë i certifikuar nga Microsoft dhe i njëjti të ketë përvojë min. 5 vite në analizimin e platformave softuerike të ngjashme. 3.4. Minimum një (1) Devops i cili duhet të ketë të përfunduar fakultetin e Inxhinierisë kompjuterike, Kompjuterikë me telekomunikacion ose shkencë kompjuterike dhe i njëjti të ketë përvojë min. 5 vite në performimin e detyrave kritike të IT-së duke përfshirë konfigurimin e pajisjeve, rikuperimin e të dhënave, konfigurimin e sistemeve. Të ketë shkollim/certifikim shtesë se paku Certifikatën CompTIA A+ ose të ngjashme. 3.5. Minimum katër (4) zhvillues të softuerëve të cilët duhet të kenë të përfunduar fakultetin e Inxhinierisë kompjuterike, Kompjuterikë me telekomunikacion ose shkencë kompjuterike dhe të njëjtit duhet të kenë përvojë min.5 vite në zhvillimin e softuerëve të ngjashëm. 3.6 Minimum një (1) ekonomist i cili duhet të ketë të përfunduar fakultetin Ekonomik dhe të jetë kontabilist i certifikuar i njëjti duhet të ketë min.5 vite përvojë pune në financa / kontabilitet. 3.7 Minimum një (1) dizajner të sistemeve softuerike i cili duhet të ketë të përfunduar fakultetin në dizajn grafik ose art vizual dhe i njëjti duhet të ketë min. 3 vite përvojë në dizajnim e projekteve softuerike të ngjashme. 3.8 Minimum një (1) Testues Softueri - Siguruesi i Kualitetit dhe Kontrollues i Kualitetit i cili duhet të ketë të përfunduar fakultetin e Inxhinierisë kompjuterike, Kompjuterikë me telekomunikacion ose shkencë kompjuterike dhe i njëjti duhet të ketë min. 5 vite përvojë në testimin e kualitetit dhe sigurisë në aplikacione softuerike të ngjashme”. Dëshmitë dokumentare të kërkuara për kërkesën numër 3 janë: “Për stafin udhëheqës profesional OE duhet të ofroj dëshmi si në vijim: Vendimin për caktimin e menaxherit të projektit, CV-të, Referencat mbi përvojën e kërkuar, Diploma (për pikat 3.2 dhe 3.3 ose Certifikata nga Microsoft, për pikën 3.4 pos diplomës duhet të ofrohet edhe Certifikata, për pikën 3.6 pos diplomës duhet të ofrohet edhe Certifikata si kontabilist i certifikuar nga njëra nga shoqatat të akredituara për certifikimin e

kontabilisteve), Kontratat e punës me punëdhënësin ose marrëveshjet mbi angazhimin për këtë projekt”

OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar dokumentin me emërtimin “4.1. Staf i dedikuar për projekt (Pjesa-1)” ku në faqen numër 3 janë paraqitur informacione lidhur me emrat e stafit që do të angazhohen në projekt. Konkretisht janë emrat e 10 personave të caktuar si staf për këtë aktivitetet dhe pozita përkatëse.

Më tej lidhur me përmbushjen e kërkesës 3 të dosjes së tenderit që lidhet me kapacitetin teknik dhe profesional, OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar dëshmitë si vijon:

Për pikën 3.1 të kërkesës, dëshmitë e dorëzuara ndër të tjera janë:

Vendimi për caktimin e personin me inicialet A.H si Menaxher i Projektit.

CV e A.H në të cilën janë paraqitur informatat në lidhje me edukimin, publikimet shkencore, përvojën e punës, pjesëmarrjen në projekte, aftësitë profesionale dhe njohuritë lidhur me gjuhët. Në lidhje me shkollimin në CV shënohet: *1. Master ne Inxhinieri kompjuterike me Telekomunikacion, Fakulteti i inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Universiteti i Prishtinës ekuivalent nga Fakulteti Drejtimi Kompjuterike me Telekomunikacion, ekuivalentuar me 23.10.2015 nga studimet e përfunduara me 28.12.2006 ne inxhinieri me 300 kredit. 2. Diplome Inxhinieri kompjuterike me Telekomunikacion, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Universiteti i Prishtinës i përfunduar me 28.06.2006.* Ndërkaq lidhur me përvojën është paraqitur përvoja nga Janar 2011 dhe vazhdon si Menaxher i projekteve në kompaninë DataProgNet, dhe përvoja tjetër Janar 2007 - Dhjetor 2010 si zhvillues softueri dhe menaxher i projektit, në kompaninë DataProgNet, Ferizaj.

Referencë e lëshuar me datë 02.10.2023 nga OE DataPrognet Sh.p.k për A.H në të cilën shënohet: *Për te punësuarin A.H i lindur me 10.08.1981 është i punësuar ne kompaninë "DataProgNet" SH.P.K qe nga 15.01.2005 dhe vazhdon ne pozitën Menaxher i projekteve dhe zhvillues i softuerit, Eksperienca e larte profesionale e A.H ne fushën e menaxhimit te projekteve, ka dhënë rezultate te shkëlqyeshme, ku mund ti gjeni ne CV dhe letër reference qe dëshmon pjesëmarrjen në projekte.*

Letër Referencë dhe dëshmi për pjesëmarrje ne projekte, ku theksohet se A.H është i punësuar

ne kompaninë "DataProgNet" SH.P.K qe nga 15.01.2005 dhe tani ne pozitën si Menaxher i projekteve. Eksperienca e larte profesionale e A.H ne fushën si Menaxher i projekteve, ka dhënë rezultate te shkëlqyeshme me sukses ne projekte ku OE i ka listuar 23 projekte me informata për emrin e projektit dhe teknologjitë përkatëse.

Dokumenti i kontratës së punës me afat të pacaktuar i lidhur në mes të DataProgNet, me seli ne Ferizaj, dhe A.H, me kualifikimi Inxhinier i Kompjuterikes me Telekomunikacion, ku specifikohet se i punësuar caktohet ne vendin e punës Menaxher i projekteve. Më tej përcaktohet se i punësuar themelon marrëdhënie pune për Pune dhe detyra specifike prej: 05.01.2011 me afate te pa caktuar.

Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, me datë 10.05.2007 në të cilën shënohet se A.H ka dhënë të gjitha provimet e parapara për të mbaruar Fakultetin e Elektroteknikës në drejtimin Kompjuterikë me Telekomunikacion dhe me këtë merr kualifikimin Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikës. Gjithashtu është dorëzuar edhe vërtetimi i noterizuar i kopjes me origjinalin.

Në lidhje me pikën 3.2 të kërkesës dëshmitë e dorëzuara ndër të tjera janë:

CV e personit S.M në të cilën janë paraqitur informatat në lidhje me edukimin, përvojën e punës, pjesëmarrjen në projekte, aftësitë profesionale dhe njohuritë lidhur me gjuhët. Në lidhje me shkollimin në CV shënohet: *1.Master ne Inxhinieri kompjuterike me Telekomunikacion, Fakulteti i inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Universiteti i Prishtinës ekuivalent nga Fakulteti Drejtimi Kompjuterike me Telekomunikacion, ekuivalentuar me 23.10.2015 nga studimet e përfunduara me 28.06.2006 ne inxhinieri me 300 kredit. 2. Diplome Inxhinieri kompjuterike me Telekomunikacion, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Universiteti i Prishtinës i përfunduar me 28.06.2006.* Ndërkaq lidhur me përvojën është paraqitur përvoja Janari 2008- vazhdon në pozitën Arkitekt i sistemit dhe Menaxher i projekteve në DataProgNet, Janar 2005 - Dhjetor 2007; Menaxher i projekteve dhe Zhvillues i softuerit ne DataProgNe, Shtator 2004 - Dhjetor 2005; Mesimdhenes i TIK-ut ne Gjimnazin "Kuvendi i Arbrit" Ferizaj dhe Gusht 2000 - Gusht 2004; Cashier, AAFES PX, American Camp Bond steel.

Letër Referencë dhe dëshmi për pjesëmarrje ne projekte, ku theksohet se S.M është i punësuar

ne kompaninë "DataProgNet" SH.P.K qe nga 15.01.2005 dhe tani ne pozitën si Arkitekt i Sistemeve dhe Menaxher i projekteve. Eksperienca e larte profesionale e S.M si Arkitekt i sistemeve, ka dhënë rezultate te shkëlqyeshme me sukses ne projekte ku OE i ka listuar 24 projekte me informata për emrin e projektit dhe teknologjitë përkatëse.

Dokumenti i kontratës së punës me afat të pacaktuar i lidhur në mes të DataProgNet, me seli ne Ferizaj, dhe S.M, me kualifikimi Inxhinier i Kompjuterikes me Telekomunikacion, ku specifikohet se i punësuari caktohet ne vendin e punës Arkitekt i Sistemet dhe Menaxher i projekteve. Më tej përcaktohet se i punësuari themelon marrëdhënie pune për Punë dhe detyra specifike prej: 05.01.2011 me afate te pa caktuar.

Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, me datë 25.04.2007 në të cilën shënohet se S.M ka dhënë të gjitha provimet e parapara për të mbaruar Fakultetin e Elektroteknikës në drejtimin Kompjuterikë me Telekomunikacion dhe me këtë merr kualifikimin Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikës. Gjithashtu është dorëzuar edhe vërtetimi i noterizuar i kopjes me origjinalin.

Certifikatën e lëshuar nga Microsoft me datë 06.11.2018, në të cilën shënohet: S.M *Has successfully completed the requirements to be recognized as a Microsoft Certified Professional.* Gjithashtu është dorëzuar edhe vërtetimi i noterizuar i kopjes me origjinalin.

Në lidhje me pikën 3.3 të kërkesës dëshmitë e dorëzuara ndër të tjera janë:

CV e e personit G.T në të cilën janë paraqitur informatat në lidhje me edukimin, përvojën e punës, pjesëmarrjen në projekte, aftësitë profesionale dhe njohuritë lidhur me gjuhët. Në lidhje me shkollimin në CV shënohet: 1. *Master ne Inxhinieri kompjuterike me Telekomunikacion, Fakulteti i inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Universiteti i Prishtinës ekuivalent nga Fakulteti Drejtimi Kompjuterike me Telekomunikacion, ekuivalentuar me 30.10.2015 nga studimet e përfunduara me 28.12.2006 ne inxhinieri me 300 kredit.* 2. *Diplome Inxhinieri kompjuterike me Telekomunikacion, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Universiteti i Prishtinës i përfunduar me 28.12.2009.* Ndërkaq lidhur me përvojën është paraqitur përvoja Janar 2011- Vazhdon; Analiste e sistemit, DataProgNet, Ferizaj dhe Maj 2009 - Dhjetor 2010; Programere dhe Instruktores e programimit dhe bazave te te dhënëve, DataProgNet, Ferizaj.

Letër Referencë dhe dëshmi për pjesëmarrje ne projekte, ku theksohet se znj.G.T është e punësuar ne kompaninë "DataProgNet" SH.P.K qe nga 05.02.2010 dhe tani ne pozitën si Analiste e Sistemit. Eksperienca e larte profesionale e G.T si Analiste e sistemeve, ka dhënë rezultate te shkëlqyeshme me sukses ne projekte ku OE i ka listuar 21 projekte me informata për emrin e projektit dhe teknologjitë përkatëse.

Dokumenti i kontratës së punës me afat të pacaktuar i lidhur në mes të DataProgNet, me seli ne Ferizaj, dhe znj. G.T, me kualifikimi Inxhinier i Kompjuterikes me Telekomunikacion, ku specifikohet se i punësuar caktohet ne vendin e punës Analiste e sistemeve. Më tej përcaktohet se i punësuar themelon marrëdhënie pune për Punë dhe detyra specifike prej: 05.01.2011 me afate te pa caktuar.

Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, me datë 01.04.2010 në të cilën shënohet se G.T ka dhënë të gjitha provimet e parapara për të mbaruar Fakultetin e Elektroteknikës në drejtimin Kompjuterikë me Telekomunikacion dhe me këtë merr kualifikimin Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikës. Gjithashtu është dorëzuar edhe vërtetimi i noterizuar i kopjes me origjinalin.

Certifikatën e lëshuar nga Microsoft me datë 22.10.2018, në të cilën shënohet: *G.T.T Has successfully completed the requirements to be recognized as a Microsoft Technology Associate.* Gjithashtu është dorëzuar edhe vërtetimi i noterizuar i kopjes me origjinalin

Në lidhje me pikën 3.4 të kërkesës dëshmitë e dorëzuara ndër të tjera janë:

CV e H.S në të cilën janë paraqitur informatat në lidhje me edukimin, përvojën e punës, pjesëmarrjen në projekte, aftësitë profesionale dhe njohuritë lidhur me gjuhët. Në lidhje me shkollimin në CV shënohet: *Diplomë Master në Shkenca kompjuterike - Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, përfunduar me 13.09.2011; 2.Diplomë Bachelor në Inxhinieri kompjuterike-Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, përfunduar me 31.10.2007.* Ndërkaq lidhur me përvojën është paraqitur përvoja Janar 2011 - Vazhdon Devops, Menaxher i projekteve, Zhvillues softueri dhe Web shërbimeve DataProgNet, Ferizaj dhe Maj 2007 - Dhjetor 2011; Programer dhe Devops, DataProgNet, Ferizaj.

Letër Referencë dhe dëshmi për pjesëmarrje ne projekte, ku theksohet se H.S është e punësuar ne kompaninë "DataProgNet" SH.P.K qe nga 02.05.2005 dhe tani ne pozitën si Devops. Eksperienca e larte profesionale e H.S si Devops, ka dhënë rezultate te shkëlqyeshme me sukses ne projekte ku OE i ka listuar 16 projekte me informata për rolin, emrin e projektit dhe teknologjitë përkatëse.

Dokumenti i kontratës së punës me afat të pacaktuar i lidhur në mes të DataProgNet, me seli ne Ferizaj, dhe H.S, me kualifikimi Master i Shkencave Kompjuterike, ku specifikohet se i punësuari caktohet ne vendin e punës Devops, Menaxher i Projekteve dhe Zhvillues softueri. Më tej përcaktohet se i punësuari themelon marrëdhënie pune për Punë dhe detyra specifike prej: 05.01.2011 me afate te pa caktuar.

Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Fakulteti i Shkencave Matematiko Natyrore, me datë 28.10.2012 në të cilën shënohet se H.S ka dhënë të gjitha provimet e parapara dhe merr titullin Master i Shkencave Kompjuterike. Gjithashtu është dorëzuar edhe vërtetimi i noterizuar i kopjes me origjinalin

Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, me datë 26.04.2008 në të cilën shënohet se H.S ka dhënë të gjitha provimet e parapara dhe merr titullin Bachelor i Inxhinierisë Kompjuterike. Gjithashtu është dorëzuar edhe vërtetimi i noterizuar i kopjes me origjinalin

Certifikatën e lëshuar nga Microsoft me datë 07.03.2023, në të cilën shënohet: H.S *has successfully achieved the certification Microsoft Certified: Azure Fundamentals*. Gjithashtu është dorëzuar edhe vërtetimi i noterizuar i kopjes me origjinalin

Certifikatën e lëshuar nga Microsoft me datë 07.11.2018, në të cilën shënohet: *H.S Has successfully completed the requirements to be recognized as a Microsoft Certified Professional*. Gjithashtu është dorëzuar edhe vërtetimi i noterizuar i kopjes me origjinalin.

Certifikatën e lëshuar nga Oracle Academy e lëshuar me datë 14.05.2015 në të cilën shënohet: *Hysen Sadiku has successfully completed 30 hours of professional development for the folloving Oracle Academy course: Java Fundamentals*.

Në lidhje me pikën 3.5 të kërkesës janë dorëzuar dëshmitë si vijon:

CV e Y.M në të cilën janë paraqitur informatat në lidhje me edukimin, përvojën e punës, pjesëmarrjen në projekte, aftësitë profesionale dhe njohuritë lidhur me gjuhët. Në lidhje me shkollimin në CV shënohet: 1. *Diplome - Universiteti i Prishtines - Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore - Departamenti i Matematikes - Shkenca Kompjuterike. Përfunduar me 07.12.2011.*; 2. *Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti" Diploma për Shkenca Kompjuterike - Master Përfunduar më 01.10.2014 – 12.09.2019.* Ndërkaq lidhur me përvojën është paraqitur përvoja 1. *Dhjetor 2011 dhe tani - Vazhdon; Zhvillues i softuerit, DataProgNet, Ferizaj.*; 2. *Tetor 2009 - Dhjetor 2009; Asistent i marketingut, Mobin, Fushe Kosove.*; 3. *Nentor 2008 - Janar 2009; Testues i aplikacioneve, Inter Adria, Prishtine.*

Letër Referencë dhe dëshmi për pjesëmarrje ne projekte, ku theksohet se Y.M është e punësuar ne kompaninë "DataProgNet" SH.P.K qe nga 01.12.2011 dhe tani ne pozitën si Zhvillues i Softuerit. Eksperienca e larte profesionale e Y.M si Zhvillues i Softuerit, ka dhënë rezultate te shkëlqyeshme me sukses ne projekte ku OE i ka listuar 16 projekte me informata për rolin, emrin e projektit dhe teknologjitë përkatëse.

Dokumenti i kontratës së punës me afat të pacaktuar i lidhur në mes të DataProgNet, me seli ne Ferizaj, dhe Y.M, me kualifikimi Master i Shkencave Kompjuterike, ku specifikohet se i punësuar i caktohet ne vendin e punës Zhvillues i Softuerit. Më tej përcaktohet se i punësuar i themelon marrëdhënie pune për Punë dhe detyra specifike prej: 01.12.2011 me afate te pa caktuar.

Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Prizerenit, Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, me datë 16.09.2019 në të cilën shënohet se Y.M ka dhënë të gjitha provimet e parapara dhe merr titullin Master i Shkencave Kompjuterike dhe Teknologji të Komunikimit. Gjithashtu është dorëzuar edhe vërtetimi i noterizuar i kopjes me origjinalin.

Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Shkencave Matematiko Natyrore, me datë 06.04.2012 në të cilën shënohet se Y.M ka dhënë të gjitha provimet e parapara dhe merr titullin Bachelor i Matematikës- Shkencat Kompjuterike. Gjithashtu është dorëzuar edhe vërtetimi i noterizuar i kopjes me origjinalin.

CV e B.K në të cilën janë paraqitur informatat në lidhje me edukimin, përvojën e punës, pjesëmarrjen në projekte, aftësitë profesionale dhe njohuritë lidhur me gjuhët. Në lidhje me

shkollimin në CV shënohet: *1. Diplome - Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Inxhinieri Kompjuterike, perfunduar me 26.11.2014.. Ndërkaq lidhur me përvojën është paraqitur përvoja Janar 2012 dhe tani- Vazhdon Zhvillues i softuerit, DataProgNet, Ferizaj.*

Letër Referencë dhe dëshmi për pjesëmarrje ne projekte, ku theksohet se B.K është e punësuar ne kompaninë "DataProgNet" SH.P.K qe nga 03.01.2012 dhe tani ne pozitën si Zhvillues i Softuerit. Eksperienca e larte profesionale e B.K si Zhvillues i Softuerit, ka dhënë rezultate te shkëlqyeshme me sukses ne projekte ku OE i ka listuar 15 projekte me informata për rolin, emrin e projektit dhe teknologjitë përkatëse.

Dokumenti i kontratës së punës me afat të pacaktuar i lidhur në mes të DataProgNet, me seli ne Ferizaj, dhe B.K, me kualifikimi Bsc. Inxhinierise kompjuterike, ku specifikohet se i punësuar caktohet ne vendin e punës Zhvillues i Softuerit. Më tej përcaktohet se i punësuar themelon marrëdhënie pune për Punë dhe detyra specifike prej: 03.01.2012 me afate te pa caktuar.

Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, me datë 30.12.2014 në të cilën shënohet se B.K ka dhënë të gjitha provimet e parapara dhe merr titullin Bachelor i Shkencave të Inxhinierisë Kompjuterike. Gjithashtu është dorëzuar edhe vërtetimi i noterizuar i kopjes me origjinalin.

Certifikatën e lëshuar nga Microsoft në të cilën shënohet: *B.K Has successfully completed the requirements to be recognized as a Microsoft Technology Associate – Database Fundamentals.* Gjithashtu është dorëzuar edhe vërtetimi i noterizuar i kopjes me origjinalin.

CV e V.B në të cilën janë paraqitur informatat në lidhje me edukimin, përvojën e punës, pjesëmarrjen në projekte, aftësitë profesionale dhe njohuritë lidhur me gjuhët. Në lidhje me shkollimin në CV shënohet: *Diplome - Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Inxhinieri kompjuterike. Përfunduar ne Dhjetor 2013. Ndërkaq lidhur me përvojën është paraqitur përvoja Janar 2014 dhe tani - Vazhdon; Ekspert për zhvillimin e softuerit (Programer), DataProgNet, Ferizaj.*

Letër Referencë dhe dëshmi për pjesëmarrje ne projekte, ku theksohet se V.B është e punësuar ne kompaninë "DataProgNet" SH.P.K qe nga 03.01.2014 dhe tani ne pozitën si *Ekspert për zhvillimin e softuerit*. Eksperienca e larte profesionale e V.B si *Ekspert për zhvillimin e softuerit*, ka dhënë rezultate te shkëlqyeshme me sukses ne 15 projekte ku OE i ka listuar me informata për rolin, emrin e projektit dhe teknologjitë përkatëse.

Dokumenti i kontratës së punës me afat të pacaktuar i lidhur në mes të DataProgNet, me seli ne Ferizaj, dhe V.B, me kualifikimi Inxhinier i kompjuterikes me telekomunikacion, ku specifikohet se i punësuar caktohet ne vendin e punës *Ekspert për zhvillimin e softuerit*. Më tej përcaktohet se i punësuar themelon marrëdhënie pune për Punë dhe detyra specifike prej: 03.01.2014 me afate te pa caktuar.

Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, me datë 03.01.2014 në të cilën shënohet se V.B ka dhënë të gjitha provimet e parapara dhe merr titullin Bachelor i Shkencave të Inxhinierisë Kompjuterike. Gjithashtu është dorëzuar edhe vërtetimi i noterizuar i kopjes me origjinalin.

CV e R.B në të cilën janë paraqitur informatat në lidhje me edukimin, përvojën e punës, pjesëmarrjen në projekte, aftësitë profesionale dhe njohuritë lidhur me gjuhët. Në lidhje me shkollimin në CV shënohet: *Diplome - Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Inxhinieri kompjuterike. Përfunduar ne Dhjetor 2013*. Ndërkaq lidhur me përvojën është paraqitur përvoja Janar 2014 dhe tani-Vazhdon; Zhvillues i softuerit, DataProgNet, Ferizaj.

Letër Referencë dhe dëshmi për pjesëmarrje ne projekte, ku theksohet se R.B është e punësuar ne kompaninë "DataProgNet" SH.P.K qe nga 03.01.2014 dhe tani ne pozitën si Zhvillues i softuerit (senior). Eksperienca e larte profesionale e R.B si Zhvillues i softuerit (senior), ka dhënë rezultate te shkëlqyeshme me sukses ne 14 projekte ku OE i ka listuar me informata për rolin, emrin e projektit dhe teknologjitë përkatëse.

Dokumenti i kontratës së punës me afat të pacaktuar i lidhur në mes të DataProgNet, me seli ne Ferizaj, dhe R.B, me kualifikimi Bachelor i inxhinierisë kompjuterike me telekomunikacion, ku specifikohet se i punësuar caktohet ne vendin e punës Zhvillues i softuerit (senior). Më tej përcaktohet se i punësuar themelon marrëdhënie pune për Punë dhe

detyra specifike prej: 03.01.2014 me afate te pa caktuar.

Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, me datë 03.01.2014 në të cilën shënohet se R.B ka dhënë të gjitha provimet e parapara dhe merr titullin Bachelor i Shkencave të Inxhinierisë Kompjuterike. Gjithashtu është dorëzuar edhe vërtetimi i noterizuar i kopjes me origjinalin

Certifikatën e lëshuar nga Microsoft me datë 12.11.2018, në të cilën shënohet: *R.B Has successfully completed the requirements to be recognized as a Microsoft Certified Professional.* Gjithashtu është dorëzuar edhe vërtetimi i noterizuar i kopjes me origjinalin.

Në lidhje me pikën 3.6 të kërkesës janë dorëzuar dëshmitë si vijon:

CV e S.A në të cilën janë paraqitur informatat në lidhje me edukimin, certifikimet, aftësitë dhe përvojën e punës. Në lidhje me përvojën shënohet se e njejta ka përvojë: Gusht 2011 deri me 28.02.2013 si kontabiliste ne NTP Dogan Trade – Ferizaj, NTP SHARRI 01.04.2013-31.01.-AKTUAL, HISNI KRASNIQI B.I. 01.02.2020-AKTUAL dhe NTSB "3E" nga 2014-vazhdon.

Marrëveshje e punës (parakontratë) për angazhimin në projekt e lidhur në mes të OE “DataProgNet”, me seli ne Ferizaj, dhe S.A, për angazhim në këtë projekt (aktivitet).

Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Ekonomik, me datë 20.04.2010, në të cilën shënohet se S.A ka mbaruar studimet themelore universitare në Departamentin Banka Financa dhe Kontabilitet dhe morri titullin Bachelor i për Banka Financa dhe Kontabilitet.

Vërtetimin e Shoqatës së Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës, në të cilin shënohet se S.A, me përfundimin e programit certifikues për kontabilistë në bazë të nenit 20 të ligjit nr. 04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim dhe Statutit të ShKCA, fion thirrjen kontabilist i certifikuar.

Në lidhje me pikën 3.7 të kërkesës janë dorëzuar dëshmitë si vijon:

CV e A.B në të cilën janë paraqitur informatat në lidhje me edukimin, përvojën e punës, pjesëmarrjen në projekte, aftësitë profesionale dhe njohuritë lidhur me gjuhët. Në lidhje me shkollimin në CV shënohet: *1. Diplome-Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Arteve, Dizajn*

Grafik. Përfunduar ne Qershor 2017. 2.Diplome - Universiteti i Prishtinës, Master i arteve aplikative -media informative me komunikim. Përfunduar ne Korrik 2019. Ndërkaq lidhur me përvojën është paraqitur përvoja Janar 2014 dhe tani- Vazhdon; Dizajnere e sistemeve softuerike, DataProgNet, Ferizaj.

Letër Referencë dhe dëshmi për pjesëmarrje ne projekte, ku theksohet se A.B është e punësuar ne kompaninë "DataProgNet" SH.P.K qe nga 03.01.2014 dhe tani ne pozitën si *Dizajnere e sistemeve softuerike*. Eksperienca e larte profesionale e A.B si *Dizajnere e sistemeve softuerike*, ka dhënë rezultate te shkëlqyeshme me sukses ne 8 projekte ku OE i ka listuar me informata për rolin, emrin e projektit dhe teknologjitë përkatëse.

Dokumenti i kontratës së punës me afat të pacaktuar i lidhur në mes të DataProgNet, me seli ne Ferizaj, dhe A.B, me kualifikimi Bachelor e Dizajnit Grafik, ku specifikohet se e punësuar caktohet ne vendin e punës Web dizajnere Më tej përcaktohet se i punësuar themelon marrëdhënie pune për Punë dhe detyra specifike prej: 03.01.2014 me afate te pa caktuar.

Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Arteve, me datë 22.07.2019 në të cilën shënohet se A.B ka dhënë të gjitha provimet e parapara dhe merr titullin Master i Arteve Aplikative – Mediat Informative dhe Komunikim. Gjithashtu është dorëzuar edhe vërtetimi i noterizuar i kopjes me origjinalin.

Diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Arteve, me datë 30.08.2017 në të cilën shënohet se A.B ka dhënë të gjitha provimet e parapara dhe merr titullin Bachelor i Dizajnit Grafik. Gjithashtu është dorëzuar edhe vërtetimi i noterizuar i kopjes me origjinalin.

Vlerësimi i ekspertit shqyrtues dhe teknik lidhur me pretendimin ankimor 2

Eksperti shqyrtues dhe teknik sqarojnë se në lidhje me pretendimin ankimor për mosplotësimin e kërkesave që lidhet me stafit, konform kërkesave numër 2 dhe 3 të dosjes së tenderit, përkatësisht dëshmime të kërkuara, OE i rekomanduar ashtu sikurse është sqaruar në mënyrë të detajuar mësipër ka dorëzuar listën e stafit dhe dëshmitë përkatëse për plotësimin e kërkesave. Rrjedhimisht, pretendimi ankimor në këtë pikë është i pabazuar.

Pretendimi ankimor 3

OE ankues pretendon se ne mungesë të qasjen në të dhëna të aktivitetit financiar përkatësisht

qarkullimit të kompanisë, dyshon se OE i rekomanduar mund të mos ketë referencat e duhura sipas kërkesës.

Vlerësimi i ekspertit shqyrtues dhe teknik lidhur me pretendimin ankimor 3

Eksperti shqyrtues dhe teknik sqarojnë se në lidhje me kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, përkatësisht kapacitetin ekonomik dhe financiar, AK në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë nuk ka përcaktuar ndonjë kërkesë. Andaj, pretendimi ankimor në këtë pikë është i pabazuar.

Pretendimi ankimor 4

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar ka dorëzuar tender me çmim jonormalisht të ulët, rrjedhimisht AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së duke e cilësuar si tender të përgjegjshëm dhe rekomanduar për kontratë.

Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 4

Sipas procesverbalit të hapjes dhe njoftimit mbi vendimin e AK-së të datës 21.11.2023, në këtë aktivitet të prokurimit tender kanë dorëzuar OE-të në vijim me çmimet përkatëse.

Data Prognat Sh.p.k (OE i rekomanduar) me çmim total të ofertës prej 118,000,00 euro

Tech Vision Sh.p.k - me çmim total të ofertës prej 133,345.00 euro

OE PBC Sh.p.k - me çmim total të ofertës prej 149,490.69 euro

Komtel Project Enginiering Sh.p.k - me çmim total të ofertës prej 187,500.00 euro

Protecht Sh.p.k; - me çmim total të ofertës prej 188,000.00 euro

Quantix L.L.C. (OE ankues) - me çmim total të ofertës prej 244,800.00 euro

Sipas shkresave të lëndës, AK ka kërkuar sqarime për çmimin jonormalisht të ulët nga OE i rekomanduar për kontratë.

OE i rekomanduar për kontratë me datë 11.11.2023, ka dorëzuar sqarimet shtesë, ku përfshihet

deklarata për zbërthimin e detajuar të kostove të tenderit. Në deklaratë janë paraqitur detajet e të gjitha pagesave dhe kostove që OE i ka kalkuluar me qëllim të arritjes të çmimi përfundimtar i ofertës prej 118,000,00 euro. Në këtë kalkulim OE ka përfshirë pagat e stafit, shpenzimet tjera indirekte ku përfshihen derivate, sigurime, energji elektrike dhe shpenzime logjistike, dhe në fund është paraqitur edhe vlera e fitimit të parallogaritur nga OE.

Vlerësimi i ekspertit shqyrtues dhe teknik lidhur me pretendimin ankimor 4

Eksperti shqyrtues dhe teknik sqarojnë se në lidhje me çmimet jonormalisht të ulëta të konstatuara sipas kriterëve të nenit 41.3 të RrPP, AK ka zbatuar procedurën *inter partes* konform nenit 41.2 RrPP. Më tej, OE ankues i rekomanduar ka dorëzuar sqarime ku ka bërë zbërthimin e kostove të parallogaritura për të gjitha elementet e ofertës. Konform nenit 41.10, AK pas pranimit të sqarimeve nga OE i rekomanduar është bindur që oferta duhet të trajtohet njëjtë me tenderët tjerë. Prandaj, AK ka vepruar në përputhje me nenin 1 dhe 6 të LPP-së dhe nenin 41.10 të RrPP, rrjedhimisht pretendimi ankimor në këtë pikë është i pabazuar.

Pretendimi ankimor 5

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së duke kërkuar sqarime në lidhje me deklaratën për mirëmbajtje, për shkak të mospërputhjes.

Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 5

AK në dosjen e tenderit, përkatësisht në Aneksin 1-specifikimet teknike të detyrueshme në fund të dokumentit ka paraqitur: “*Shënim: Prej momentit të vënies në funksion të projektit, OE është i obliguar rreth mirëmbajtjes për një (1) vit.*”

OE i rekomanduar ka dorëzuar dokumentin “2. Plani dinamik” në të cilin është shënuar se mirëmbajtja është 12 muaj (1 vit) nga momenti i funksionalizimit dhe pranimit të projektit.

Më tej është dorëzuar dokumenti “1. Dokumentacioni i kërkuar” në të cilin në faqe 17 është prezantuar deklarata “Deklarata për Mirëmbajtjen” në të cilin shkruhet: “*Me kete dokument deklarojme se dote bejme mirembajtjen dhe japim garancion per projektin me numer te prokurimit: UA/2016-23-9009-2-1-1 dhe titulli "Krijimi i sistemit elektronik te proceseve per nevojat e Komisionit te Pavarur per Media E-KPM-ja" konform kerkesave ne dosjen e tenderit per 24 muaj (2 vite) pas pranimit te projektit dhe brenda çmimit te ofruar, ne rast se kontrata*

behët me kompaninë DataProgNet SH.P.K.”

AK me datë 01.11.2023 ka kërkuar sqarime nga OE i rekomanduar për kontratë me tekstin si vijon: *“Pyetja 1. Tek deklaratë për mirëmbajtje ju keni deklaruar që do të ofroni mirëmbajtje prej 24 muajve (dy vite) ndërsa tek specifikat është 12 muaj dhe ne të dyjat ju e kemi nënshkruar dhe vulosur. Ju lutem sqaroni sa do të ofroni mirëmbajtje, mbrapa cilës deklaratë qëndroni.”*

OE i rekomanduar për kontratë me datë në përgjigje të kërkesës për sqarime shtesë ka deklaruar si vijon: *“Tek Dosja e Tenderit - Kushtet dhe kërkesat e dërgesës pika 5.2. Afatet kohore për fillimin dhe ose përfundimin e kontratës: 24 muaj. Bazuar në këtë kërkesë ne kemi dhënë deklaratë se do të ofrojmë mirëmbajtje prej 24 muaj (dy vite). 1.b. Tek Dosja e tenderit - ANEKS 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME Shënim: Prej momentit të vënies në funksion të projektit, OE është i obliguar rreth mirëmbajtjes për një (1) vit. Bazuar në këtë kërkesë tek propozimi teknik kemi ofruar mirëmbajtje 12 muaj pas vënies në funksion të sistemit. Pasi që afatet kohore për fillimin dhe ose përfundimin e kontratës janë paraparë 24 muaj, ndërsa tek ANEKS 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME është kërkuar që prej momentit të vënies në funksion të projektit, OE është i obliguar rreth mirëmbajtjes për një (1) vit, ju njoftojmë se DataProgNet SH.P.K. për mirëmbajtjen e sistemit do të ofroj mirëmbajtje një (1) vit (12 muaj) pas vënies në funksion të sistemit ashtu siç kemi deklaruar tek plani dinamik dhe propozim teknik që kemi dhënë konform kërkesave në dosjen e tenderit (deklarata e dhënë për 24 muaj bazuar te pika 5.2. e dosjes së tenderit ka të bëjë me afatet kohore për fillimin dhe ose përfundimin e kontratës brenda 24 muaj për zhvillim, implementim dhe mirëmbajtje të sistemit). DataProgNet SH.P.K. qëndron mbrapa deklaratës 12 muaj të ofrimit të mirëmbajtjes pas vënies në funksion të sistemit ashtu siç kemi deklaruar tek plani dinamik dhe propozim teknik”.*

Vlerësimi i ekspertit shqyrtues dhe teknik lidhur me pretendimin ankimor 5

Eksperti shqyrtues dhe teknik fillimisht sqarojnë se është e evidente se OE i rekomanduar për kontratë ka dhënë dy afate të ndryshme në dy dokumente në lidhje me periudhën mirëmbajtjes. Afatin prej 24 muaj në deklaratën për mirëmbajtje dhe afatin 12 muaj në planin dinamik. Duke qenë që dy afatet e deklaruara të mirëmbajtjes përmbushin afatin minimal prej 12 muaj të specifikuar në dosjen e tenderit, atëherë sqarimi i AK është në funksion të qartësisë të informatave të dhëna në tenderin e OE të rekomanduar. Andaj eksperti shqyrtues

dhe teknik sqarojnë se afati për mirëmbajtje është konform afatit të specifikuar në dosjen e tenderi, rrjedhimisht pretendimi ankimor është i pabazuar.

Pretendimi ankimor 6

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së duke kërkuar sqarime në lidhje me aspekte teknike të propozimit teknik të dorëzuar nga OE i rekomanduar.

Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 6

AK në dosjen e tenderit, tek Aneks 1 -Specifikimet Teknike Të Detyrueshme, ka paraqitur kërkesat funksionale dhe jofunksionale që duhet ti përmbushë sistemi i cili do të zhvillohet nga OE i shpërblyer me kontratë.

Në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit AK nuk ka paraqitur kërkesë për dorëzimin e propozimeve teknike nga OE-të e interesuar që të dorëzojnë tender në këtë aktivitet të prokurimit.

OE i rekomanduar ka dorëzuar dokumentin “3.Propozimi teknik” në lidhje me modulën Auditranskriptimi, ku ka shënuar “DataProgNet SH.P.K do të de`shmoj se posedojnë platforme” e cila ka njohje të ke`naqshme të gjuhës shqipe dhe me ane` të Inteligjencës Artificiale ajo shkon duke u pë`rmirësuar. Njohja e prituri duhet të jetë minimum 90% për gjuhën standarde shqipe dhe pë`rmirësimi do të bëhet gjatë punës së mëtutjeshme të projektit.”

Në lidhje me këtë shënim AK me datë 01.11.2023 ka kërkuar sqarime nga OE i rekomanduar për kontratë me tekstin si vijon:Pyetja 2.“DataProgNet SH.P.K do të dëshmojë se posedojnë platrofmë e cila ka njohje të kënaqshme të gjuhës shqipe dhe me anë të Inteligjencës Artificiale ajo shkon duke u përmirësuar. Njohja e prituri duhet të jetë minimum 90% për gjuhën standarde shqipe dhe përmirësimi do të bëhet gjatë punës së mëtutjeshme të projektit “ ky citat i juaji qe ne dosje te tenderit ka qen pjese e specifikave teknike te detyrueshme. Ju lutem sqaroni si do ta dëshmoni këtë pjesë.

OE i rekomanduar për kontratë me datë në përgjigje të kërkesës për sqarime shtesë ka deklaruar si vijon: “DataProgNet SH.P.K. posedon të një platformë testuese në ASP.NET Core me C# & Python që do të ofroj njohje të kënaqshme të gjuhës shqipe me Inteligjencë

Artificiale dhe që do të shkoj duke u përmirësuar gjatë periudhë së projektit, ku më poshtë kemi paraqitur hapat/fazat që kemi ndjekur dhe do të ndjekim si plan zhvillimi:

Krijimi i Projektit në ASP.NET Core & Python:

Krijimin i projektit në ASP.NET Core & Python gjuhët programuese. Përdorimi i Bibliotekave të Njohjes së Gjuhës Natyrore (NLP): Përdorimi i bibliotekave të njohjes së gjuhës natyrore për trajtimin dhe analizën e teksteve në gjuhën shqipe. Disa biblioteka të njohura që planifikohen të përfshihen janë: spaCy, NLTK, dhe Hugging Face Transformers. Do të përdorim këto biblioteka për të ndihmuar në analizën e tekstit dhe për të krijuar modele të mësimi automatik të specializuara për gjuhën shqipe.

spaCy: Spacy është një bibliotekë e njohjes së gjuhës natyrore e pasur dhe e specializuar për shumë gjuhë, duke përfshirë edhe shqipen. Kjo bibliotekë ofron analizë morfologjike, analizë sintaksore, dhe shërbime të tjera për trajtimin e tekstit në gjuhën shqipe. NLTK (Natural Language Toolkit): NLTK është një bibliotekë e njohjes së gjuhës natyrore e zhvilluar në Python. Ajo ofron mjetet dhe burimet e nevojshme për analizën e tekstit në shqip dhe për zhvillimin e aplikacioneve të ndryshme të bazuar në gjuhën natyrore. Hugging Face Transformers: Hugging Face ofron një koleksion të madh të modeleve të mësimi automatik të gjuhës natyrore të shqipes. Ky resurs është i dobishëm për të përdorur modele të gatshme për punë me tekst në gjuhën shqipe ose për të zhvilluar modele të personalizuar për detyra të veçanta. Këto biblioteka janë mjetet e vlefshme për shqyrtimin dhe analizën e tekstit në gjuhën shqipe, dhe përdoren gjëndeje në projektet e shumta që përdorin analizën e tekstit dhe mësimin automatik në këtë gjuhë.”

Vlerësimi i ekspertit shqyrtues dhe teknik lidhur me pretendimin ankimor 6

Eksperti shqyrtues dhe teknik sqarojnë se nisur nga fakti që AK në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit nuk ka përcaktuar kërkesë për dorëzimin e propozimeve teknike, sqarimet e AK-së janë në funksion të shtjellimit të zgjidhjeve që duhet të implementohen dhe është e qartë që OE-të duhet të përmbushin të gjitha specifikimet teknike të paraqitura në dosjen e tenderit gjatë fazës së implementimit. Megjithatë, konform nenit 56, paragrafi 3 i LPP-së, tenderuesi nuk mund të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit,

rrjedhimisht pretendimi ankimor është i pabazuar në këtë pikë.

Pretendimi ankimor 7

OE ankues pretendon se tenderët e dorëzuar nga OE-të Tech Vision Sh.p.k; Protecht Sh.p.k; Komtel Project Engineering Sh.p.k kanë dorëzuar tender të cilët janë të papërgjegjshëm për mosplotësimin e kriterëve/kërkesave të dosjes së tenderit.

Vlerësimi i ekspertit shqyrtues dhe teknik lidhur me pretendimin ankimor 7

Në lidhje me pretendimet ankimore të OE ankues për tenderët e OE-ve Tech Vision Sh.p.k; Protecht Sh.p.k; Komtel Project Engineering Sh.p.k, eksperti shqyrtues dhe teknik sqarojnë se sipas njoftimit mbi vendimin e AK-së të datës 21.11.2023, OE e sipërpërmendur janë eliminuar dhe të njëjtit nuk kanë paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së, rrjedhimisht nuk janë palë me interes material në këtë aktivitet të prokurimit. Andaj pretendimet ankimore në lidhje me tenderët e këtyre OE-ve janë të palejuara.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Rekomandimi i ekspertit shqyrtues dhe teknik

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues dhe teknik i propozojnë panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**Quantix L.L.C.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Krijimi i sistemit elektronik të proceseve për nevojat e Komisionit të Pavarur për Media E-KPM-ja**” me numër të prokurimit: “**UA/2016-23-9009-2-1-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Agjencia Qendrore e Prokurimit**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Agjencia Qendrore e Prokurimit**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **Quantix L.L.C.**

ismail rushiti



Kreshnik Spahiu

